**Projekti KSV/801**
**Mbështetja e Bashkimit Evropian për Rikualifikimet Profesionale dhe Profesionet në Arsimin dhe Aftësimin Profesional (“ESVET PRO”)**

**Financuar nga Bashkimi Evropian**

# Ftesë
# Prezantimi i Raportit Fillestar të Projektit

E nderuara/I nderuari Zonjë/Zotëri,

Si Këshilltar Kryesor Teknik i Projektit KSV/801- Mbështetja e Bashkimit Evropian për Rikualifikimet Profesionale dhe Profesionet në Arsimin dhe Aftësimin Profesional (“ESVET PRO”) financuar nga Bashkimi Evropian, kam kënaqësinë të ju ftojë në ngjarjen e prezantimit të raportit fillestar të projektit. Kjo ngjarje do të mbahet **të martën, më 26 janar 2021, nga ora 14:00 -16:00 nëpërmjet platformës ZOOM.**

Qëllimi i Projektit ESVET PRO është që të kontribuojë në zhvillimin e një sistemi të arsimit dhe aftësimit që bazohet në cilësi, që është gjithëpërfshirës dhe i përgjegjshëm, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Agjencia e Luksemburgut për Zhvillim të Bashkëpunimit.

Kjo ngjarje i ka dy objektiva kryesore: objektivi i parë është që ta prezantojë progresin që e ka arritur Projekti gjatë fazës fillestare, dhe t’i ndajë me ju aktivitetet që parashihen në të ardhmen; dhe objektivi i dytë është që t’i identifikojë dhe t’i mbledhë propozimet për ndër-veprim dhe bashkëpunim nga projektet e tjera, nga akterët e AAP-së, ndërmarrjet private, OJQ-të dhe individët të cilët janë të interesuar të kontribuojnë në zhvillimin e sektorit të AAP-së në Kosovë.

Gjuha që do të përdorët gjatë kësaj ngjarje është anglishtja me përkthim simultan në gjuhën shqipe.

Draft agjenda e ngjarjes është bashkangjitur për informim tuajin. Ju lutemi ta konfirmoni pjesëmarrjen tuaj, si dhe ta shpërndani këtë ftesë tek kolegët tuaj para **të hënës, më 25 janar 2021**, duke e dërguar një e-mail në blond.gerqari@luxdev.lu

Besoj sinqerisht se do të jepni një kontribut pozitiv dhe shpresoj të shihemi në këtë ngjarje. Ju lutemi mos hezitoni të na kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje shtesë.

Në pritje të pjesëmarrjes tuaj.

Sinqerisht i Juaji,

**Daniele Cristian Passalacqua**
Këshilltar Kryesor Teknik, Projekti KSV/801

Të bashkëngjitur: Agjenda e ngjarjes.